

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Mimoza Llastica" rikthehet pas 53 vitesh, filmi i Xhanfise Kekos restaurohet në 4K dhe mbyll festivalin në Tiranë - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/mimoza-llastica-rikthehet-pas-53-vitesh-filmi-i-xhanfise-kekos-restaurohet-ne-4k-dhe-mbyll-festivalin-ne-tirane/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:12:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4ad515d5b53a0b6e3849001c8b2cdc1f1db5c5bec9a073cd05ddfee3b6c1ba
TEKSTI	1c3091e9829efb78b873b84401577c98f6f401264041bd2b8f5d82e43aa45147
PAMJA	10f79f2af0665e5035fb4bfbcee95e0b8711882f95aa1a2a52953a4e160ce782

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9183a3fe59ae5a383830695a423a1d73174284537ec0a0eeecfde87954d9390
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcec101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9183a3fe59ae5a383830695a423a1d73174284537ec0a0eeecfde87954d9390>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » "Mimoza Llastica" rikthehet pas 53 vitesh, filmi i Xhanfise Kekos restaurohet në 4K dhe mbyll festivalin në Tiranë

KULTURË

Demo

"Mimoza Llastica" rikthehet pas 53 vitesh, filmi i Xhanfise Kekos restaurohet në 4K dhe mbyll festivalin në Tiranë

SEPTEMBER 28, 2026



Një prej filmave më të dashur të kinematografisë shqiptare, "Mimoza Llastica", është rikthyer në ekran në një version të restauruar në 4K, më shumë se gjysmë shekulli pas realizimit të tij.

Filmi i regjisoresh Xhanfise Keko, një prej emrave më të rëndësishëm të kinematografisë shqiptare për fëmijë, vijon të ruajë edhe sot një lidhje të veçantë me publikun. Gjuha e sinqertë dhe ndjeshmëria me të cilën është trajtuar historia kanë bërë që filmi të mbetet pjesë e kujtesës së disa brezave.

Restaurimi i filmit u realizua në Romë, me mbështetjen financiare të Teuta Doçit, një prej vajzave që luajtën në film dhe që iu bashkua e para nismës së Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit "Adopto një film për restaurim".

Për Doçin, rikthimi i filmit në një version të restauruar ishte një emocion i veçantë, pasi ajo ishte pjesë e tij 53 vite më parë.

"Mendova pse të mos e bëj restaurimin e një filmi ku unë isha pjesëmarrëse para 53 vitesh. Ishte një emocion i rrallë. E bëra me shumë kënaqësi. Falënderimi u takon atyre që realizuan këtë film. Ne ishim tetë vajza të vogla dhe ata u morën me ne me shumë dashuri", tha Teuta Doçi.

Ndërkohë, drejtori i Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, Eljan Tanini, vlerësoi punën e gjatë të realizuar për restaurimin e filmit, duke theksuar rëndësinë që ai mbart edhe për shkak të aktorëve të vegjël dhe punës së regjisoresh Xhanfise Keko.

"Ka qenë një punë e gjatë restaurimi i këtij filmi, që përbën një kureshtje sa i përket aktorëve të vegjël, Xhanfise Keko, që u mor me këtë film, e të tjerët", u shpreh Tanini.

Versioni i restauruar në 4K i "Mimoza Llastica" u shfaq si filmi përmbyllës i Tirana International Film Festival. Në natën finale të festivalit u zhvillua edhe ceremonia e ndarjes së çmimeve për filmat, regjisorët dhe aktorët më të mirë të edicionit.

Rikthimi i filmit në ekran, në një cilësi të re teknike, solli kështu edhe një herë para publikut një prej veprave që ka lënë gjurmë në kinematografinë shqiptare për fëmijë.

filmi Tiranë Xhanfise

SHARE.



Postimet e reja

Vdekja e George Mazonakis, infermierja...

SEPTEMBER 28, 2026

Avioni bën ulje emergjente në Portugali,...

SEPTEMBER 28, 2026

"Mimoza Llastica" rikthehet pas 53 vitesh,...

SEPTEMBER 28, 2026

George dhe Amal Clooney, 12 vite martesë: Rregulli...

SEPTEMBER 28, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç "Delvina Gas" ai...

ALERT në Sloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë përmbytje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të "Top Fruits"
të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

[Facebook](#)[Instagram](#)[YouTube](#)[TikTok](#)

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Dashuri, vendime dhe mundësi të reja: Si do të shkojë e diela për secilën shenjë

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

[raporto këtu](#)

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.